

PËRMBLEDHJE E DËGJESËS PUBLIKE

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrative-Territoriale

Qarku Elbasan | 28 Prill 2026

1. Konteksti dhe kuadri i dëgjësës

Dëgjësja publike e Elbasanit u zhvillua më 28 prill 2026, si pjesë e konsultimeve parlamentare për qeverisjen vendore. Diskutimi u përqendrua te territori, modeli i qeverisjes, funksionet, kompetencat, shërbimet dhe financat vendore, me fokus praktik te përvoja e qytetarëve, të zgjedhurve vendorë, shoqërisë civile, përfaqësuesve të administratës vendore dhe aktorëve lokalë në bashkitë e qarkut.

2. Qeverisja vendore dhe përfaqësimi

Gjetje kryesore

- Afërsia e shërbimit me qytetarin mbetet kriteri kryesor për vlerësimin e funksionimit të bashkive, njësive administrative dhe modelit të qeverisjes në territor.
- Në qarkun e Elbasanit u evidentuan vlerësime të ndryshme mbi efektet e reformës së vitit 2015: disa ndërhyrje theksuan rritjen e kapaciteteve, të ardhurave dhe investimeve, ndërsa të tjera ngritën shqetësime për largimin e vendimmarrjes nga komunitetet rurale dhe zonat fundore.
- Përfaqësimi vendor shihet si hallkë e rëndësishme e demokracisë vendore; u ngrit shqetësimi se disa zona rurale, malore dhe ish-komuna nuk ndihen të përfaqësuara mjaftueshëm në vendimmarrjen bashkiake.
- Njësitë administrative, kryepleqtë dhe administratorët lokalë u përmendën si mekanizma të nevojshëm për të mbajtur lidhjen e përditshme midis bashkisë dhe komunitetit.

Gjetje dytësore

- Qarku i Elbasanit ka profil të kombinuar urban, rural, malor, industrial, bujqësor, turistik dhe historik; kjo kërkon një model qeverisjeje që balancon ekonominë e shkallës me afërsinë ndaj qytetarit.
- Identiteti lokal, trashëgimia historike, rruga Egnatia, Peqini, Shpati, Gjinari, Gramshi, Librazhdi, Prrenjasi, Cerriku, Belshi dhe zona të tjera u përmendën si elemente që ndikojnë në mënyrën si perceptohet organizimi territorial.
- Shpopullimi, migrimi nga zonat rurale dhe largimi i të rinjve u ngritën si shqetësime që lidhen me cilësinë e shërbimeve, aksesin, mundësitë ekonomike dhe ndjesinë e përfaqësimit.
- Roli i nivelit të dytë të qeverisjes, qarkut ose rajonit, u përmend si i rëndësishëm për funksione që kërkojnë koordinim më të gjerë, pa zëvendësuar nevojën për shërbim të afërt në komunitet.

3. Mbështetja ligjore dhe burimet

Gjetje kryesore

- Kuadri ligjor duhet të qartësojë më mirë raportin midis përgjegjësive, kompetencave, funksioneve dhe burimeve financiare që u jepen bashkive.
- Delegimi ose transferimi i funksioneve kërkon shoqërim të plotë me financim, staf, mjete pune dhe standarde të matshme shërbimi.
- Kapacitetet njerëzore dhe teknike mbeten kusht për ofrimin efektiv të shërbimeve, veçanërisht në bashki me territor malor, zona rurale të shpërndara dhe nevoja të mëdha infrastrukturore.
- U theksua nevoja për administratë vendore më profesionale, të trajnuar dhe të aftë për të përgatitur projekte, përthithur fonde dhe menaxhuar përgjegjësi më të gjera.

Gjetje dytësore

- U ngrit nevoja që riorganizimi territorial të mbështetet në analizë të thelluar, kritere funksionale, demografike, gjeografike, ekonomike dhe sociale, dhe jo vetëm në shembuj të veçuar.
- Bashkitë kërkojnë më shumë kompetenca reale për administrimin e territorit, veçanërisht në fusha ku përgjegjësia vendore prek drejtpërdrejt jetën e qytetarëve.
- Ligjet sektoriale dhe vendimmarrjet qendrore u përmendën si faktorë që mund të kufizojnë autonominë praktike të bashkive kur nuk harmonizohen me ligjin organik të vetëqeverisjes vendore.
- Shërbimet sociale, mjedisi, pyjet, uji, kanalizimet, emergjencat civile dhe administrimi i pasurive natyrore kërkojnë ndarje më të qartë të rolit të pushtetit vendor dhe atij qendror.

4. Funksionet, kompetencat dhe shërbimet

Gjetje kryesore

- Shërbimet bazë kanë njohur përmirësime në disa njësi administrative dhe bashki, sidomos në rrugë, pastrim, kanalizime, vaditje, kullim dhe mirëmbajtje të hapësirave publike, por cilësia dhe afërsia e tyre nuk perceptohen njësoj në të gjithë qarkun.
- Rrugët rurale, aksesit nga zonat malore, ujitja, kullimi, kanalizimet, furnizimi me ujë, pastrimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës u evidentuan si fushat ku qytetari mat më drejtpërdrejt funksionimin e bashkisë.
- Ujësjiellësi dhe shërbimet e ujit paraqesin rezultat të përzier: u ngritën shqetësime për largimin e shërbimit operacional pas organizimit rajonal, ndërsa u theksua nevoja që ky funksion të jetë më i lidhur me bashkitë dhe qytetarët.
- Shërbimet sociale kërkojnë mbështetje më të qëndrueshme në të gjitha bashkitë, sidomos për gratë dhe vajzat në situata dhune, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe komunitetet në nevojë.

Gjetje dytësore

- Në zonat rurale dhe malore të Gramshit, Librazhdit, Prrenjasit, Peqinit dhe njësive të Elbasanit u ngrit shqetësimi për distancën fizike nga shërbimet dhe për mungesën e infrastrukturës lidhëse.
- Në disa zona, si Shpati, Gjinari, Polisi dhe njësi të tjera, u vlerësua se bashkitë më të mëdha kanë mundësuar investime, pastrim, mirëmbajtje dhe projekte që ish-komunat nuk mund t'i përballonin vetë.
- Bujqësia, blegtoria, pyjet, kullotat, vaditja dhe kullimi kërkojnë përgjegjësi më të qarta dhe planifikim më të lidhur me ekonominë lokale.
- Trashëgimia kulturore, turizmi malor, rruga Egnatia, zonat historike dhe resurset natyrore kërkojnë shërbime vendore të integruara dhe kapacitete për promovim, mirëmbajtje dhe zhvillim ekonomik.
- Ndotja industriale në Elbasan dhe ndikimi i saj në tokë, shëndet, bujqësi dhe turizëm u ngritën si çështje që kërkon kompetenca, financim dhe përgjegjësi më të qarta territoriale.

5. Parimet e financimit të njësive të qeverisjes vendore

Gjetje kryesore

- Financimi vendor u trajtua si kusht themelor për autonominë reale të bashkive dhe për aftësinë e tyre për të ofruar shërbime cilësore në të gjithë territorin.
- U evidentua nevoja që funksionet e transferuara ose të deleguara të shoqërohen me fonde të mjaftueshme, të parashikueshme dhe të përdorshme sipas prioriteteve vendore.
- Raporti midis shpenzimeve për administratë, pagave, shpenzimeve operative dhe investimeve u ngrit si çështje kyçe për matjen e efikasitetit të bashkive.
- Formula e financimit duhet të reflektojë më mirë sipërfaqen, terrenin malor, distancën nga qendra, shpërndarjen e popullsisë, nevojat infrastrukturore, kostot sociale, ndotjen dhe potencialet ekonomike të secilës zonë.

Gjetje dytësore

- Në disa ndërhyrje u propozua vendosja e kufijve ose standardeve minimale për pjesën e buxhetit që shkon për investime, me qëllim që rritja e të ardhurave të përkthehet më qartë në shërbime.
- Të ardhurat nga aktivitetet industriale, burimet natyrore, taksat kombëtare të gjeneruara në territor dhe kostot mjedisore u përmendën si elemente që duhet të reflektohen më mirë në financimin vendor.
- Bashkitë me territor të gjerë rural ose malor kanë nevojë për mbështetje qendrore për investime që nuk mbulohen dot vetëm nga të ardhurat vendore.
- Autonomia financiare kërkon jo vetëm rritje të fondeve, por edhe fleksibilitet në përdorim, lidhje me prioritetet lokale dhe transparencë mbi kthimin e taksave në shërbime.

6. Transparenca dhe llogaridhënia

Gjetje kryesore

- Qytetari ka nevojë për një adresë të qartë përgjegjësie për çdo shërbim: kush vendos, kush financon, kush zbaton dhe kush mban përgjegjësi kur shërbimi mungon ose është i pamjaftueshëm.
- Llogaridhënia dobësohet kur shërbimet largohen nga komuniteti, kur njësitë administrative kanë rol të kufizuar dhe kur përfaqësimi në këshillat bashkiakë nuk perceptohet si i mjaftueshëm.
- Procesi i reformës duhet të mbështetet në konsultim real me qytetarët, veçanërisht me komunitetet fundore, zonat rurale dhe grupet që preken më shumë nga shërbimet vendore.
- Transparenca financiare duhet të lidhë më qartë të ardhurat, grantet, tarifat, shpenzimet për administratë dhe investimet konkrete në çdo territor.

Gjetje dytësore

- U kërkua që dëgjesat dhe mekanizmat e konsultimit të mos mbeten vetëm në qendrat e qarqeve, por të shtrihen edhe në njësitë dhe komunitetet që e përjetojnë më drejtpërdrejt distancën nga shërbimi.
- Këshilltarët bashkiakë, administratorët e njërive administrative dhe kryepleqtë janë hallka kyçe për komunikimin me qytetarin, por kërkojnë rol më të qartë, përgjegjësi dhe mekanizma raportimi.
- Publikimi i të dhënave për investimet, buxhetin, shërbimet, ankesat dhe prioritetet territoriale do të ndihmonte rritjen e besimit në administratën vendore.
- Një reformë e qëndrueshme kërkon që gjetjet e dëgjesave të reflektohen në analizën përfundimtare dhe të shoqërohen me kriteret e qarta vendimmarrjeje.

Shënim metodologjik

Ky dokument është hartuar mbi bazën e transskriptit të plotë të dëgjesës publike dhe përfaqëson të gjitha zërat e shprehura, duke ruajtur balancimin ndërmjet qasjeve divergjente. Ai nuk shpreh qëndrimin zyrtar të Komisionit, por dokumenton diversitetin e opinioneve të shprehura gjatë sesionit. Dëgjesa u moderua nga Valbona Karakaci, Këshilltare Strategjike pranë projektit Bashkitë Forta, dhe u regjistrua në tërësi. Transkripti i plotë dhe ky raport do të bëhen publike në faqen e reformës.